



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM
PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESAVE ANKIMORE NR.13, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN
29.05.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKTI: Për mospranimin për shqyrtim kërkesës ankimore Nr.13, datë 29.05.2019, të paraqitur nga subjekti ankues Partia Bashkimi Liberal Demokrat me objekt: Kundërshtimi i vendimit nr.22, datë 21.05.2019 të KZAZ-së nr.63 "Për mos regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Kucovë".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa "b" dhe nenin 130 germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Liberal Demokrat ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me nr. 13 regj, datë 29.05.2019.



Nr. 738 i Vendimit

Data 30.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për mos pranimin për shqyrtim të kërkesave ankimore nr. 13 të paraqitur në KQZ në datën
29.05.2019

Në mbledhjen e datës 30.05.2019, ora 17:00 pas relatimit të znj. Edlira Jorgaqi, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike kërkesa nr.13 u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 dhe në mbështetje të nenit 129 pika 1, 3, germa "b", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Kërkesa Ankimore nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 129, pika 1, 3, germa "b" dhe nenin 130 germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.13, datë 29.05.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Bashkimi Liberal Demokrat.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

